



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"

SENATI AKADEMIK

Nr. 3063 Prot.

Shkodër, më 30.09. 2025

V E N D I M

Nr. 252, datë 30.09 2025

**PËR PROPOZIMIN E NJË NDRYSHIMI NË VENDIMIN E BORDIT TË
ADMINISTRIMIT NR. 74, DATË 10.03.2023 "PËR MIRATIMIN E TARIFËS VJETORE
TË SHKOLLIMIT NË PROGRAMIN E STUDIMIT TË DOKTORATËS PËR STAFIN
AKADEMIK ME KOHË TË PLOTË"**

Bazuar në Ligjin nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", Ligjin nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 3, pika 3, gërma c); neni 95; neni 98, pika 3) 108, pika 4); VKM Nr. 75, datë 12.2.2018 "Për miratimin e modelit të financimit të Institucioneve Publike të Arsimit të Lartë", IV); Vendim nr. 879, datë 18.12.2019 për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të këshillit të ministrave, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", pika 2.12, gërma a); Statutit i USH-së, neni 5, pika 3, neni 17, neni 56, pika 3, neni 58, pika 4, Senati Akademik, në mbledhjen e tij të datës 30.09.2025,

VENDOSI:

1. T'i propozojë Bordit të Administrimit kryerjen e një ndryshimi në pikën 1, të vendimit të tij nr. 74, datë 10.03.2023 "Për miratimin e tarifës vjetore të shkollimit në programin e studimit të doktoratës për stafin akademik me kohë të plotë", si vijon:

Ishte: *Miratimin e mbulimit të tarifës vjetore të shkollimit në programin e studimit "Doktoratë", për stafin akademik me kohë të plotë.*

Të bëhet: *"Miratimin e mbulimit të tarifës vjetore të shkollimit në programin e studimit "Doktoratë", për stafin akademik me kohë të plotë, vetëm për kohëzgjatjen normale të programit*

të studimit, që i referohet periudhës 3 (tre) vite akademike, me përjashtim të rrethanave objektive të justifikuara me dokumentacion provues, si dhe për shkak të forcave madhore.

2. Ky vendim i përcillet Bordit të Administrimit për miratim përfundimtar.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT

Prof. dr. Tonin Gjuraj

